



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, ëeb: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), Tel: +35522400150

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË  
BASHKISË SHKODËR ”.**

**Konsultim publik :** *Banorët e Nj. Administrative Rrethina, Pult, Shalë dhe Shosh.*

**Data :** 05.10.2022      **Ora :** 13.00      **Vendi:** Salla e restorantit tek market “Api”

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesëmarrësve 32, nga të cilat 2 gra dhe vajza.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Per draft projekt planin buxhetor afatmesem 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

**Pjesëmarrës :** *Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur liste prezenca).*

**Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetari i bashkisë dhe Kryetarja e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :**

## **I: ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, I MESEM I PERGJITHSHEM, PROFESIONAL**

**Z. Taulant Shahmati, Shkolla e Ismet Sali Bruçaj :** - Pjesë e dëgjesave në vitet e fundit, i është dhënë në vite prioritet disa gjërave por ndryshimet janë të vogla. Brenda godinës kemi kopshtin parashkollor si dhe klasën e parë deri tek e nënta. Kemi vetëm katër ambjente me 150 nxënës. Duke marrë parasysh që jemi drejt dimrit është një shkollë me numër të qëndrueshëm të nxënësve, nga komunikimet deri tani nuk shoh asnjë fillim punimesh por akoma nuk kemi asgjë.

Fshati Guci e Re nuk ka hapësira publike apo qendra rinore apo objektet të tjera ku pjesa e komunitetit të mbledhet për të pasur jetë sociale e komunitare .Do doja një përgjigje konkrete që të mundem t'i jap edhe banorëve të tjerë që s'janë këtu.

**Kryetari i Bashkisë :** - Në nëntor fillojnë punimet në këtë shkollë, nga ana e Bashkisë ka pasur nxitje për të filluar sa më shpejt por në nëntor është e sigurt që do të fillojnë punimet për shkollën Ismet Sali Bruçaj. I kemi vlerësuar me prioritet këto ndërhyrje.

**Z. Taulant Shahmati, Shkolla e Ismet Sali Bruçaj:** - Kazanat e mbeturinave vijnë të jenë afër shkollës , nuk e di se si mund të organizohet kjo pjesë që të kemi një ndërgjegjësim por edhe një lëvizje të tyre të mundshme.Po zihen rrugët dhe shtigjet nga ana e banorëve dhe nesër kur të behen shtëpi në këto rrugë e shtigje duhet te pastrohen dhe të identifikohen .Rruga e varrezave i prek këto njerëz duke sistemuar të gjithë situatën ,është nje rrugë e shkurtër dhe me pak investim përmirësohet.Rruga nga mbarimi i asfaltit deri në kishën e Shëngjinit ,vijne njerëz nga e tërë Shqipëria dhe nga vija e Vrakës kalojnë në këmbë përmes një rruge shumë te keqe. Gropat e hapura nga shirat pasi u bënë prerjet në asfalt akoma nuk kanë filluar të mbushen me asfalt në fshatrat Grudë,Guci ,Golem etj .

**Kryetari i Bashkisë :** - E kemi diskutuar dhe është bllokuar nga ana e motit kjo pjesë e investimit , ne jemi në kontakt me firmën zbatuese dhe janë duke rifilluar me zbatimin , kur porositet asfalti porositet në sasi të mëdha dhe kjo ka krijuar problemet e veta. Kjo pjesë sa diskutohet do të marrë zgjidhje së shpejti.

**Z.Ahmet Vataksi banues në fshatin Zues** - Investimi është ajo që është me e dukshmeja në komunitet duke u reflektuar direkt, një rrugë na është aprovuar në 2021 por banorët pyesin gjatë gjithë kohës për fillimin e saj.Problematike është rruga e vorrezave në mes të Zuesit që është e gjatë 200 metra. Problem kemi edhe sa i përket prorit të rrugës së Drinit ku ujrata e zeza të familjareve sidomos në kohë vere kanë ndotje të madhe dhe për këtë kerkohet investim ne këtë ndërhyrje sepse është shumë e nevojshme.Po ashtu rruga që të çon në rezervuarin e ujit te pijshëm duhet vlerësuar dhe të krijohet mundësia për ndërhyrje dhe të vihet në prioritetet e Njesisë.

Shkolla e Zuesit ka pak femijë ,dikur ka pasur roje por sot jo , ndërkohë duhet të ketë të paktën kamera ne këtë shkollë.

Tapi tokash ka pak ose fare në këte zonë, duhet krijuar një komision i cili të fillojë këtë proces si për shtëpitë ashtu edhe për pronat e tokave.

Kemi problem vorrezat ku ka disa përrenj malor të cilat ndikojnë negativisht në zonën e varrezave.

**Zv. Kryetari i Bashkisë:** - Të dyja rrugët janë prioritet i bashkisë dhe kur vlerësohen janë realisht të realizueshme dhe në fillim të vitit të ardhshëm do të fillojnë si zbatim. Kanalin e kemi vlerësuar edhe së bashku .Sa i përket rojeve të shkollave duhet vlerësuar për të gjitha shkollat që të behet një investim i tillë meqenëse bëhet fjalë për një shkollë mund të identifikohet mundësia që të realizohet instalimi i kamerave të sigurisë.

**Ndoc Ashta – Kryetari i njësive administrative Shosh** - Për sa i përket zonës tonë më e detyrueshmja është rruga nga Prekali deri në Bregun e Lumit janë në total 50 km rrugë e cila me vite ka mbetur e pa rikualifikuar edhe një km është i nevojshëm për të pasur impakt pozitiv në këtë zone, të planifikohet një fadromë në dispozicion për këtë segment që është në shërbim të të tre njësive administrative malore.

Sa i përket shkollave e dimë që ka rënë numri i nxënësve dhe dihet që nuk është prioritet.

Pyjet, sa i përket kesaj pjese kërkojmë vëmendje nga ana e bashkisë me prita malore, pastrime të ndryshme për një sërë ekonomish malore me frutat e pyjeve .

Zonat tona janë larg nga qyteti dhe me vështirësi ,kemi nevojë për 2- 3 punëtor me kontrata që shërbejnë në zonë për periudha të caktuara duke ndiku në përmirësimin e disa situatave që mund të zgjidhen shpejt me pak punëtorë.

**Zv. Kryetari i Bashkisë:** -Rruga e Dukagjinit është një përpjekje e vazhdueshme e Bashkisë, kemi akorduar 12 milion lek të reja sa i përket ndërhyrjes në segmentet rrugore ku është dëmtuar shumë. Vlera prej 3 milion lek të reja janë shpenzuar sa i përket mirëmbajtjes së rrugës nga Nderlysa deri në Breg të Lumit .Do të ndërhyjmë në rrugën e malit të Shoshit ku është e nevojshme të kemi ndërhyrje rehabilituese. Për të asfaltuar rrugën e Dukagjinit është e pamundur që të realizohet me fondet e Bashkisë Shkodër. Një fadromë mirëmbajtjeje do të jetë e mundur të vendoset në dispozicion nga ana jonë.

Fondi pyjor nuk është në inventar të Bashkisë Shkodër por megjithatë kemi mundësinë dhe do e shohim me përparësi që të ndërhyjmë për ruajtjen e këtij fondi i cili na pengon nga mungesa e kuadrit ligjor për menaxhimin e fondeve pyjore duke mos na lejuar që të vendosim gjoba .Kemi diskutuar edhe me Prefekturën sa i përket kesaj çështjeje që të kemi një kuadër ligjor që organi inspektues i Bashkisë të ketë mundësinë për të ndërhyrë.

**Tomë Marku – Kryetari i Njësive Administrative Pult:** -Ndoshta ky diskutim edhe me Këshillin Bashkiak për problematikat e zonave malore i kanë të ngjashme problematikat ku 47 km rrugë janë të parregjistruara ,banorët e planit investojnë vetë në këto rrugë por duke mos ditur

rregullat dhe problematika duke qenë se bashkia nuk e ka në fond zonën e Bruçaj më konkretisht: 4 km Plani, 4 km Gjuraj etj .. Cila është baza ligjore që këto rrugë të rregjistrohen dhe të ndahet dhe a e ka Ministria e Infrastrukturës ne pronësi apo Bashkia Shkodër?

Ka 8 vite apo 30 vite ku duhet të kemi nevojë për të realizuar një mulli që bluan produktet në zonë ,gjithashtu edhe në urat e prrojve duhet investuar dhe të jenë të qëndrueshme për pjesën e dimrit ku prroj rriten dhe i bëjnë të pakalueshme.

Nuk është në dorë te Bashkisë por duhet që zonat malore të kenë dokumenta pronësie pasi as për shtëpitë as për tokat dhe as për shtëpitë e para viteve '90 kullota etj asnjë dokument nuk ekziston për këtë zonë. Dihet që tokat ruhen në atë zone nga banorët por kjo ben që ato të mos mund ti investojne as shesin apo shfrytezojne keto pasuri ndaj kerkoj të gjindet mënyra për rregjistrim të këtyre pronave nga ana e shtetit shqiptar.

Problem tjetër është sa i përket 2200 hektar gështenja është dëmtimi nga grenza e zezë ,si pasojë e saj ka një rënie të prodhimit me 70 % i cili është një e ardhur kryesore për komunitetin në këtë zonë.

Në lidhje me bujqësinë nqs sado pak njerezit kanë nevojë për vaditje apo për kullime sqaroj se aty nuk eshte vënë dorë që 30 vite.

Ne lidhje me rrugën e makinës kjo rrugë është për 3 njesitë administrative malore në të njëjtën gjendje të amortizuara. Duhet gjetur një formë tjetër dhe jo vetëm me mirëmbajtjen por edhe ndikimin përmes qeverisë etj te jete një fadromë dhe punetore që bëjnë mirëmbajtjen e saj sepse kur i jepen paratë firmës është e pamundur qe të kemi realizim konkret te punëve nga një tenderim ,kemi shembull rrugën e Planit qe me fonde te vëta ka ndryshuar totalisht.

**Kryetari i Bashkisë :** - Sa i përket vaditjes miser, groshe, zarzavate, patate etj dhe këto kanë të nevojshme vaditjen dhe duhet të kemi investime që të shikohen në vend përmes vendosjes së tubave ,unë sugjeroj që të sigurohet baza materiale nga Bashkia dhe puna të behet vetë nga banorët.

**Tomë Marku – Kryetari i Njësisë Administrative Pult:-**Sa i përket rregjistrimit te rrugës?

**Zv. Kryetari i Bashkisë:** - Duhet të ndërtohet kur Bashkia ka pronë në këtë tokë ,sa i përket rregjistrimit te pronës se tokës do të verifikojme dhe gjejmë një zgjidhje.

**Kryetari i Bashkisë :** - Sa i përket urave duke qenë se Ministria e Mbrojtjes mund të ndërhyjë në këto ura do të përpiqemi të realizojmë një nderhyrje nga ana e tyre përmes ndërgjegjësimit të tyre qoftë edhe me një takim mes palëve.

Ky takim degjesë duhet të shërbejë për të nxjerrë problematikat dhe nevojat dhe të marrim prioritetet që Bashkia Shkodër e ka të mundur për t'i realizuar.

**Petrit Arra – Kryetari i Njësisë Administrative Shalë:** - Njesia Administrative Shalë është njësi e madhe në sipërfaqe popullore ka lëvizur por prap ka banorë dhe ka nevoja – rruga është e mire dhe e pranueshme kemi problem sa i përket mbeturinave ku deri në Nderlyse nuk ka kosha dhe rrethimi i tyre – nga problemet e kuajve duke u dukur sikur njerezit i hedhin në tokë nevojitet rrethimi me gardh apo dicka i këtyre koshave .

Problem kemi dy ura baili, një urë e cila lidh portat e Shales me katër fshatrat në Rastukije . Dhe një urë që lidh Shoshin me Bregun e Lumit dy ura baili ose të bëhen me bazament.

Është e nevojshme për dy mullinj të riparohen apo ndërtohen ,dikur i kemi ba vete por tashmë duhen bërë nga Bashkia, është e nevojshme sepse misri apo produkti i bërë në Shalë nuk duhet të vijë në Shkodër për t'u bluar. Kemi problem tjetër rrethimin e varrezave kryesore të cilat janë funksionale. Rruga e makinës është arsyeja kryesore e shpopullimit nga fermentimi në Breg të Lumit duhen 7 orë sepse nuk arrihet të kalohet më shpejt.

**Kryetari i Bashkisë :** - Duhet të bëjmë një takim me Petritin sepse edhe ne i kemi të limituara mundësitë duke përfshirë ndoshta edhe bizneset e zonës .

Problemin e varrezave mund ta zgjidhim përkohësisht duke bërë një rrethim edhe me drunj.

Në lidhje me problemin e urave duhet të marrim kontakt edhe me Ministrinë e Mbrojtjes pasi janë të specializuar në ndërhyrje të tilla dhe mund të na asistojnë.

**Drejtor Shkolle Shtoj i Ri, Erjan Nikaj :-** Kemi një ambient shumë të vogël brenda ndërtesës që ka nevojë dhe mundësi të zmadhohet kopshti pasi ka më shumë se 25 fëmijë . Sistem qendror ngrohje a mund të ketë sepse ngrohja vetëm me stufa nuk realizohet dhe a mund të ketë një shkollë në rrethina një sistem ngrohjeje qendrore?

**Kryetari i Bashkisë :** - Prioriteti jonë ka qenë dhe mbetet heqja e gazit nëpër shkolla, ndërkohë kjo është realizuar në masën maksimale të mundshme por normalisht ne duam të bëjmë edhe më shumë por tani për tani këto janë mundësitë tona reale.

**Znj. Selmane Grepj, Drejtor Shkolle Shtoj i Ri, kerkoi:-** Plehrat i kemi tek dera e shkollës dhe kjo mbetet problem, duhet të gjendet mundësia për t'i larguar. Kemi nevojë për rrethimin e shkollës sepse kalojnë fëmijët nga ambientet e jashtme të shkollës. Po ashtu edhe për lysterjen e shkollës edhe pse ka filluar një pjesë të realizohet.

Pjesa e rrugës që ka mbetur pa u shtruar për të ardhur në shkollë duhet të rregullohet sepse krijon shumë probleme.

Nga klasat e kopshteve duhet të bashkohen me pjesën e shkollës dhe ambientet e kopshtit të mbesin si ambiente rekreacionale dhe informatike etj , duke bërë një ndërhyrje të lehtë ku të kemi mundësi për krijim të ambienteve të reja duke eliminuar kështu edhe heqjen e orëve të masdites. Këto 6 klasa të kalohen në ambientet e shkollës . Kemi një shkollë të shkëputur nga

kopshti Isa Jakupi ne Dobraq dhe është në fazë zbatimi por akoma s'kanë filluar punimet , klasa e parë me kopsthin duhet te jetë e ndarë në ambjente. Tek pjesa e rojeve kemi problem që të jetë edhe gjatë procesit mësimor.

Sa i përket sinjalistikës rrugore duhet që të kemi një tabelë tek vijat e bardha ku të krijojmë siguri për fëmijët që i frekuentojnë shkollat.

### **Z.Zija Çinari banues i fshatit Golem :**

1. – Drita në fshatin Golem të paktën të vendosen ndricuesa pasi janë rrugë që lidhin edhe fshatra të tjera.

2.- Kanalizimet e ujërave të zeza duhet të sistemohen duke qenë se edhe Golemi ka shumë problem me to prandaj duhebn të riparohen pasi janë të gjitha me probleme teknike.

**Kryetari i Bashkisë :** - Sa i përket ndriçimit ju sqaroj se ka mbaruar faza e tenderimit dhe do të fillojë vendosja e ndriçuesve në zonën e Golemit.

**Z.Agron Fangaj banor i fshatit Bardhaj:** - Kemi bërë një kërkesë për hapje kanalesh si pasojë e avullive qe janë te ndërtuara mbi kanale, kemi problem sepse përmytemi komplet si zonë për një avulli mbi një kanal.Ne nuk mund t'i bëjmë vetë keto ndërhyrje dhe na nevojitet nga ana juaj një fadromë që mund të vij në Bardhaj dhe të pastrojë te gjithë këto kanale.

**Kryetari i Bashkisë :** - Së fundimi jemi hasur me këtë problem prandaj është me rëndësi që të kemi edhe ndergjegjësim për këtë pjesë. Çdo kanal që është në zonë nuk është pronë e askujt dhe të gjithë kanë bërë shkelje në këtë drejtim.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj :** - Kemi nxjerrë një urdhër me Kryetarin sa i përket kësaj pjese, në urdhër kemi caktuar strukturat që do të veprojnë në këtë drejtim.Theksoj që ne akoma nuk kemi filluar që të zbatojmë dhe reflektojmë mbi këtë urdhër që ka krijuar strukturën për ndërhyrje në këtë pjesë .

Kemi rrugë të zëna, qendra të zëna, kanale të zëna dhe pjesa që bllokun zhvillimin dhe dëmton me shumë janë kanalet dhe rrugët e zëna .

Kemi përfshirë edhe Policinë e Shtetit në këtë aksion por është e rëndësishme që të kemi bashkëpunim dhe ndergjegjësim të banorëve sepse po nuk u rrit ndergjegjësimi është e pamundur ndërhyrja.

**Z.Vesel Tusha banues në fshatin Dobraq i ri :** - Kemi shumë kërkesa Z.Dedaj dhe Erjoni i dijne mirë problematikat tona , problem kryesor është rruga dhe kanali i ujrave të zeza. Rruga është përfunduar deri në një pjesë por kanali i ujrave të zeza që vjen nga Rusi për në Dobraq etj, vjen dhe derdhet në Bardhaj duke krijuar një problem shumë të madh.

Tek rruga tek fabrika Klegen ka një tjetër problem sepse e tërë hirra derdhet në kanalën e ujrave të Bardhajve.

Problem tjetër është tek kthesa e varrezave aty ka përherë aksidente sepse është shumë e dobët në parametra dhe ka nevojë që të ketë sinjalistikë sepse nuk ka tabela fare tashmë rruga është bërë por duhet medeomos të ketë sinjalistikë rrugore si dhe aty nuk ka as kanal të ujrave të zeza.

Problem tjetër është bypassi, ka kriju mundësi të mira për lagjen tonë por e ka ndarë duke mbyllur hyrjet dhe daljet me Dobracin e ri i cili ka mbetur në pjesën poshtë duke lënë qendrën shëndetësore të pa aksesueshme nga hekrat duke bllokuar kalimin sepse nuk ka më akses ndërkohë që lagjen e ka 700 meter larg, të paktën një dalje për këmbësoret duhet të ketë .

**Kryetari i Bashkisë :** - Do të bëjmë diskutim me ARRSH sepse është pjese e tyre administrimi i rrugës së bypassit. Rruga akoma nuk është dorëzuar në Bashkinë Shkodër që të na mundësojë ne nderhyrje sipas kërkesave tuaja pa cënuar parametrat teknik te rrugës.

Tanimë kërkohet një qendër e re shendetësore sepse nuk është e aksesueshme ekzistuesja dhe për banoret është shumë problematike kjo pjese dhe ne mirëkuptojmë por nga ana jonë duhet të gjendet toka dhe mund të kemi edhe nderhyrje te përbashkët për fshatin Dobraç i Ri.

Në lidhje me kanalet theksoj se edhe për ne është problem sepse e dimë këtë problematikë tuajen por duhet që inxhinierët mbikqyrës të jenë të vëmendshem dhe të mos kenë konflikt interesi me kërkesat tona në mënyrë që të punohet për të mirën e të gjithëve.

**Kryeplaku i fshatit Shtoj i Vjetër :** - Ne kemi shumë kërkesa por duhet të asistojme rrugën e shtojit të Vjetër pasi ka nevojë per tre katër makina që të kenë nderhyrje me stabilizant.

Tek shkolla dhe qendra shëndetësore kemi prishur disa avulli por sërisht ka filluar zënia e këtyre rrugëve përmes avullive.

Kalojmë tek varrezat ku një emigrant po bën nje nderhyrje private me fondet e veta dhe unë kërkoj që të kemi mirëmbajtje të varrezave nga ana e Bashkisë.

Tapiat dhe problemet e tokave,të gjithë ne kemi toka por nuk kemi si ti aksesojme këto prona pasi nuk kemi rrugë.

Tek ndriçimi është hera e disatë që akoma nuk kemi një ndriçues.

Ujin e kemi me presion por nuk ka shpërndarje të rregullt, ka matësa, ka tuba dhe ujë nuk ka në diza zona.

Tek rruga e klubit me dërrasa ka shumë shtëpija dhe nuk ka rrugë të asfaltuar.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj :** - Kemi marrë prioritetet e rrugëve sipas fshatrave dhe kur është diskutuar për rrethinat kemi pasur një vlerë prej 2. 5 milion euro plan për të bërë ,kemi

aplikuar tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe kemi një mundësi që nga 60 projekte te dërguara të miratohen 15 prej tyre dhe të fillojnë së shpejti zbatimin.

Janë zgjedhur më të rëndësishmet dhe aktualisht kemi 5 rrugë në Njësinë Administrative Rrethina që janë duke filluar së shpejti ndërsa tek problemi i pronave pa rrugë nga zënia e paligjshme kemi urdhërin e sipërcituar që duhet zbatuar.

**Kryeplaku i fshatit Bruçaj:** - Banorët e këtij fshati kanë nevojë të kenë ndriçim , kemi bërë një sërë ankesash por akoma nuk është marrë asnjë përgjigje ,bashkia duhet te krijojë një mbështetje për këtë zonë pasi janë 500 banorë dhe ka nevojë per ndriçim dhe elektricitet.

Në lidhje me vaditjen kemi nevojë për 300 metra kanal vaditës me tub uji dhe ka nevojë që të ketë investim për këtë zonë përmes një tubi uji.

Problem tjetër është ai i shkollës e cila duhet mirëmbajtur.

**Kryetari i Bashkisë :** - Zgjidhja duhet të jetë ndërtimi i një hidrocentrali të vogël sepse ndikon në të gjitha fushat që nga jetesa e banoreve tek zhvillimi i turizmit që vlen të theksohet se kjo zonë ka potencial turistik.

Për kanalet vaditëse kam patur rastin të takohem me Ministren e Bujqësisë për zonat rurale dhe kam marrë informacion se që nga 2017 nuk ka pasë asnjë investim për kete pjesë .

Ministria e ka marrë këtë informacion dhe më ka premtuar që do të ketë vëmendje të rritur për vitin tjetër për kanalet vaditëse.

**Kryetari:** - Duke ju falenderuar për opinionet dhe nevojat e paraqitura ju falenderoj sërish dhe shpresojmë që të kemi mundësinë të realizojmë keto propozime të bera sot këtu nga ana juaj.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.


**Mbajtësi i Procesverbalit:**

Bekim Mema









BASHKIA  
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.  
Nj.Administrative Rrethina, Pult, Shosh, Shalë.

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Neloc Aokta		M	64	Shoek Shkodër	jurist	Aparatshkroter
2	Skendar	Tajipi	M	66	Zues. Shkodër	Udhësues	Dezajner Shkolle.
3	Ahmet	Vetelcaj	M	68	Fus-shkodër	Periciorist	F/Plak
4	Henel Teresh		M	58	Dobruçaj	Shkolltar	
5	Lide Urkaj		M	58	Hatirin	Gjeograf	44m p. i. kroat
6	Sokoe Arili		M	57	Hatirin	Gjeograf	Pa punë
7	Lotef Kloci		M	32	Shkodër	Martë	B. Shkodër
8	GERGJ NIKA	NIKA	M	59	SHKODER	Specio lit mjed. B. SHKODER.	
9	Agton Fajngj		M	37	BARDHAJ	HRAPPLAKT/ SPECIJLIST KAMALIZIMEV VADISE	
10	FRAN BEOCHINA		M	73	BIGRAN	HRAPPLAK	
11	Alban Shkollari		M	52	Shkodër	Bashkod	Angjellor
12	Alfred Shkolle		M	56	Shkodër	Jurist	Bashkia Shkodër
13	Firdaus M'Nijaj		M	60	Shkodër	specjaliste	Jashin Shkodër

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA  
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Nj.Administrative Rrethina, Pult, Shosh, Shalë.

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Bledar	Preu	M	35	Shkoder	Insp.Taksos	Bashkia Shkoder
15	Eriq	Dilaveri	M	40	Shkoder	Ing.	-/-
16	Yasminja	Gjekati	F	38	Shkoder	Ekonomiste	Bashkia
17	Fiedkan	Sokaki	M	62	Shkoder	Inzhinier	B. Shkoder
18	Yaima	Hagajeri	F	54	SHKODER	Mesazhe	I V A S H
19	Ardit	C. Shkoder	M	36	SHKODER	Mesazhe	I V A S H
20	Tocirant	Shahmani	M	39	Guciere	Arxhivor shkolle	ZVAPSH
21	WARIO	ROSECI	M	55	Golemithra.	Ekonomice	PD
22	ARIAN	LILKA	M	55	Shkoder	mesazhe	shtoj i vjeter
23	Lufti Drini		M	50	Shtoj i Sh.	Panton	Kepunare
24	Ded Gjoni		M	52	Grujdere	Kryeplak	Vetperac
25	Ajron	Sedihaj	M	51	SHTOJ I R C	KRYEPLAN	MONITORUS
26							

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

